

SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-122/12

Prishtinë,  
19 shkurt 2013

Në çështjen juridike të

**N. R.**

Gjakovë

*Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala ankuese*

kundër

**K.Z.**

Krushevc

*e përfaqësuar nga*

**M. R. V.**

Krushevc  
Srbi

*Paraqitësja e kërkesës/Pala Përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Antarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/144/2012

(lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA27143), të datës 29 shkurt 2012, pas shqyrtimit të mbajtur me 19 shkurt 2013, mori këtë

### **AKTGJYKIM**

- 1- Anulohet sipas detyrës zyrtare vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/144/2012, i datës 29 shkurt 2012, për sa i përket lëndës së regjistruar me numrin KPA27143, dhe hedhet poshtë kërkesa pasi që ajo nuk është në kuadër të juridiksionit të KKPK-së.**
- 2- Pala përgjegjëse duhet t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 60 € (gjashtëdhjetë) brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.**

#### **Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

Me 28 shkurt 2007, M. R. V. si anëtare e familjes së ngushtë të bartësit të së drejtës pronësore ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar konfirmimin e së drejtës pronësore të nënës së saj (tani të ndjerë) ndaj një banese që ndodhet në rrugën Dimitrija Tucovica 44 [shënimi i gjykatës: tani mbase njihet si Marin Baleti 44] në Gjakovë, me sipërfaqe prej 61 m<sup>2</sup>. Ajo ka deklaruar se nëna e saj K.Z. ishte pronare e banesës. Kjo banesë i ishte lëshuar kumatës së saj N. R.e cila do ta shfrytëzonte atë me pëlqimin e pronarit deri në shitjen e saj. Më vonë gjatë procedurës, ajo ka paraqitur në AKP një autorizim të dhënë nga motra e saj, K. Ž..

Pas njoftimit të kërkesës, është përgjigjur N. R., e cila ka konfirmuar deklaratën e gjertanishme të paraqitëses së kërkesës pasi që së sipas saj, banesa i ishte dhënë asaj para 28 viteve dhe se që nga ajo kohë ajo dhe familja e saj kishin jetuar në atë banesë.

Më vendimin KPCC/D/R/144/2012, KKPK-ja e kishte miratuar kërkesën e M. R.V. dhe kishte vendosur se ajo kishte vërtetuar se K. M. Z. është pronare e pronës.

Vendimi i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë 31 korrik 2012.

Më 24 gusht 2012, pala përgjegjëse në kërkesë (këtej e tutje: pala ankuese), ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme. Ajo ka kundërshtuar vendimin për arsye të shkeljes së të drejtës materiale dhe procedurale dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe ka propozuar që të ndryshohet vendimi i kundërshtuar.

Sipas saj, vjehrra e saj tani e ndjerë ishte larguar nga Kosova gjatë luftës. Ajo ka shtuar se vetë ajo kishte jetuar në banesë së bashku me bashkëshortin e saj për 40 vite dhe se pagesa e banesës ishte bërë nga bashkëshorti i saj, i biri i K.Ž. Ajo ka njoftuar gjykatën se ajo kishte paraqitur kërkesë qysh në vitin 2007 në Gjykatën Komunale të Gjakovës për konfirmim të së drejtës së pronësisë. Përveç kësaj, pala ankuese e konsideron vetën si trashëgimtare të vjehrrës së saj.

Paraqitësja e kërkesës (tani: pala përgjegjëse në ankesë), e përfaqësuar nga M. V., ka reaguuar ndaj ankesës, duke propozuar që ajo të refuzohet. Ajo ka deklaruar se K. Ž. ende ishte gjallë dhe se pala ankuese nuk ishte trashëgimtare e saj pasi që edhe bashkëshorti i palës ankuese po ashtu ishte ende gjallë. Ajo gjithashtu ka deklaruar se pala ankuese nuk ka mundur të përfitojë të drejtën pronësore me anë të parashkrimit pasi që pala ankuese e dinte se ajo nuk ishte pronarja. Për më tepër. Provat e paraqitura nga pala ankuese nuk japin dëshmi se banesa është e saj.

### **Arsyetim ligjor**

Gjykata së pari dëshiron të cek se palë në procedurë janë N. R. si palë përgjegjëse në kërkesë/palë ankuese dhe K. Ž. si paraqitëse e kërkesës/palë përgjegjëse në ankesë. M. V. është përfaqësuese e paraqitëses së kërkesës/palës përgjegjëse në ankesë sipas autorizimit të dhënë nga K. Ž. dhe si e tillë ajo nuk është palë në kërkesë.

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh të paraparë në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Megjithatë, ankesa është pabazuar. Kërkesa nuk ka mundur të miratohet pasi që ajo nuk është në kuadër të juridiksionit të KKPK-së (neni 11.4 (a) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079). Sidoqoftë, pasi që KKPK-ja nuk e ka hedhë poshtë kërkesën për mungesë juridiksioni por vendosi në bazë të meritave të lëndës dhe e ka miratuar kërkesën, ky vendim duhet të anulohet sipas detyrës zyrtare dhe në vend se të miratohet kërkesa, ajo duhet të hedhet poshtë.

Ndonëse KKPK-ja si organ kuazi gjyqësor duke vendosur mbi meritat e kërkesës tashmë e ka pranuar juridiksionin e tij, gjykata vlerëson sipas detyrës zyrtare nëse lënda bie në kuadër të fushëveprimit të juridiksionit të tij (neni 195.1 b i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore).

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon të drejtën ndaj pronësore por edhe që ai apo ajo nuk kanë qenë në gjendje t'i ushtrojnë të drejtat e këtylla pronësore për shkak të rrethanave që drejtpërsëdrejti ndërlidhen apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Megjithatë, në këtë rast, nuk ka dëshmi dhe as ndonjë indikacion të mjaftueshëm se humbja e pronës ka ndonjë lidhje me konfliktin e armatosur të vitit 1998/1999. Në të kundërtën, vetë pala përgjegjëse në ankesë ka deklaruar se ai ia kishte dhënë banesën palës ankuese që të jetojë në të. Pala ankuese vetëm ka qëndruar në banesë dhe tani e deklaron banesën si të vetën, ndonëse pala përgjegjëse në ankesë deklaron se banesa është e nënës së saj, në asnjë aspekt nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur të vitit 1998/1999.

Rastet si këto nuk janë në kuadër të fushëveprimit të juridiksionit të KKPK-së apo të Kolegjit të Apelit të AKP-së, ato duhet të gjykohen nga gjykatat e përgjithshme kompetente civile.

Prandaj, vendimi i KKPK-së lidhur me kërkesën duhet të anulohet sipas detyrës zyrtare dhe kërkesa duhet të hedhet poshtë në mungesë të juridiksionit të KKPK-së dhe gjykatës.

Ky vendim i gjykatës nuk paragjykon të drejtën e palës përgjegjëse në ankesë që të kërkojë konfirmimin e së drejtës së saj pronësore para autoriteteve kompetente vendore

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të UA 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë me arsye mund të vlerësohet në 20.000 € : 30 €.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që humb rastin. Në përputhje me nenin 45.1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë për personin me vendbanim jashtë vendit është jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë dhe jo më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

**Këshillë juridike:**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

**Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**